



Funded by  
the European Union



**QKRMT** Qendra Kosovare për Rehabilitimin  
e të Mbijetuarve të Torturës  
**KRCT** The Kosova Rehabilitation  
Center for Torture Victims

### Termet e Referencës

“Trajner për qasjen e mirë informuar për traumën për ofruesit e shërbimeve që punojnë me të mbijetuarit e dhunës seksuale lidhur me konfliktin”.

**Projekti:** 4CRSVsurvivors-“Rrugët drejt fuqizimit: Promovimi i drejtësisë, shërimit dhe gjithëpërfshirjes për të mbijetuarit e dhunës seksuale lidhur me konfliktin”

#### **1. Konteksti:**

Si pjesë e projektit rajonal të BE-së “Mbështetje për ndërtimin e besimit në Ballkanin Perëndimor”, i financuar nga Bashkimi Evropian (BE) dhe i cili zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) si përfituese, do të organizojë trajnim për ofruesit e shërbimeve që punojnë me të mbijetuarit e dhunës seksuale lidhur me konfliktin.

QKRMT është një organizatë joqeveritare e themeluar në vitin 1999 që ofron shërbime ndërdisiplinore në mbështetje të viktimave civile të luftës, veçanërisht të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë. Më tej, QKRMT-ja është e përfshirë në identifikimin, vlerësimin, trajtimin, referimin dhe monitorimin e të mbijetuarve të dhunës me bazë gjinore në mesin e të riatdhesuarve dhe personave me shqetësim për UNHCR-në (të kthyerit, refugjatët, personat e zhvendosur brenda vendit dhe personat në rrezik të pashtetësisë).

Gjithashtu, në kuadër të mandatit të saj për të promovuar dhe avancuar respektimin e të drejtave të njeriut për personat e privuar nga liria, QKRMT kryen vizita të rregullta monitoruese në vendet si: burgje, qendra të paraburgimit, qelitë e paraburgimit të policisë, institucionet e shëndetit mendor dhe gjithashtu promovon praktikat dhe standardet legislative për mbrojtjen dhe ngritjen e nivelit të respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria.

QKRMT-ja e sheh rolin e saj në shoqëri si ofrues i shërbimeve, ndërgjyqëse dhe mbikëqyrës i të drejtave të njeriut. Me rëndësi të veçantë ka qenë përpjekja e vazhdueshme dhe e fuqishme avokuese që ka bërë QKRMT me institucionet qeveritare në adresimin e nevojave të të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, si dhe personave të privuar nga liria.



## 2. Objektivat:

Objektivi kryesor i këtij trajnimi është të ndërtojë kapacitete të ofruesve të shërbimeve për të ofruar mbështetje efektive për të mbijetuarit e dhunës seksuale në konflikte, duke përdorur një qasje të ndjeshme dhe të informuar për traumën.

## 3. Fokusi i Punës dhe rezultatet e pritura:

### Trajneri/ja do të punojë në:

- Përpilimin e një koncepti të punës për trajnimin:
  - Dizajnimi i një agjende kurrikule të kompletuar në qasjen e mirë-informuar për traumën dhe kujdesin e informuar për traumën, të përshtatur për nevojat e ofruesve të shërbimeve në punën e tyre me të mbijetuarit e dhunës seksuale në konflikte.
- Ofrimi i trajnimit një ditë duke përdorur metodologji interaktive:
  - Punë në grupe, studime rasti dhe aktivitete të tjera për të siguruar pjesëmarrje aktive dhe përmirësim të njohurive.
- Përgatitja e një raporti narrativ të trajnimit.

## 4. Kohëzgjatja

Procesi i kryerjes së punëve të cekura në pikën 3 duhet të përfundojë në periudhën kohore nga: **27 deri më 31 maj 2024.**

## 5. Kualifikimet dhe Përvoja

- Përvojë pune e paktën 5 vjet në fushën e psikologjisë, mjekësisë, apo shkencave sociale.
- Përvojë në përpilimin e dokumenteve/materialeve informuese, raporteve, si dhe në ofrimin e trajnimeve të ngjashme.
- Përvoja paraprake me të mbijetuar apo me organizata që merren me të mbijetuarit e dhunës seksuale në konflikt konsiderohet përparësi.

## 6. Buxheti

Ka një buxhet të caktuar për këtë shërbim të ofruar, duke përfshirë pagesë konkurruese në përputhje me ekspertizën dhe përvojën.



## **7. Procesi i aplikimit:**

Personat e interesuar ftohen të dorëzojnë CV-në e detajuar që thekson eksperiencën relevante, shembuj të punës së mëparshme në një fushë të ngjashme, në QKRMT në [info@krct.org](mailto:info@krct.org), duke shënuar në titull të emailit “Trajner për ofruesit e shërbimeve”, deri më **20 maj 2024**.

### **Shënim:**

QKRMT rezervon të drejtën të refuzojë një ose të gjitha propozimet e pranuar.

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës  
15 maj, 2024.